



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2020:128705

Datë: 08.04.2022

Numri i dokumentit: 02897179

P.nr.1022/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DIVIZIONI PENAL e përbërë nga gjyqtari Shabi Idrizi dhe me bashkëpunëtorin profesional Driton Ahmeti, në çështjen penale kundër të pandehurit S.S nga Fshati ... Komuna Shtërpcë, për shkak të veprës penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.II.nr.1271/20 e datës 30.11.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 05.04.2022, në praninë e përfaqësuesit të akuzës - prokurorit të shtetit Zana Sadiku Sertolli, të pandehurit S.S, me datë 08.04.2022 mori dhe publikisht komunikoi këtë dhe të njëjtën ditë përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri: S.S nga i ati C. dhe ëma D., e gjinisë Z.. i lindur me me vendbanim në Fshatin ... – Komuna Shtërpcë, i pa punë, i martuar prind i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, serbë, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal ..., i pa dënuar më parë, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se,

Më datë 06.07.2020. rreth orës 20:30, në rrugën “...” në Ferizaj përkatësisht në afërsi të stacionit të derivateve (pompës) “E....” hetuesit policor të DHTN-së në asistim me njësitin policor (patrollues) kanë ndaluar për kontroll veturën e markës “...” ngjyrë e zezë, me targa, pas kontrollimit më të detajuar të veturës, i pandehuri kishte pranuar se në veturën e tij posedon dy qese najlloni të mbushura me substancë narkotike e llojit heroinë ku i pandehuri i posedonte

pa autorizim me q'rast edhe i sekuestrohet përkohësisht nga raporti i ekspertimit me nr.AKF/2020-2050/2020-1787 i datës 17.11.2020 nga konstatimi dhe mendimi përfundimtar i ekspertimit ka rezultuar se dëshmitë 1.1 dhe 1.2 përmbajnë substancë narkotike e llojit Heroinë në përzierje me Acetaminofen (paracetamol) dhe kafeinë peshë neto e përgjithshme 1.23 gram.-

-me këtë ka kryer veprën penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 të KPRK-së.

Andaj, Gjykata në bazë dispozitës së lartë shënuar si dhe neneve: 2, 17, 21, 38, 69, 70, 71, 72, 81 dhe 82 të KPRK-së, si dhe në bazë të neneve 365, 370, 453, 463, të KPP-së, te pandehurit S.S i shqipton,

VËREJTJE GJYQËSORE

Me të cilën të pandehurit i bëhet me dije se ka kryer veprë të dëmshme dhe të rrezikshme që përbën veprë penale dhe nëse kryen prapë veprë të tillë, gjykata do ti shqiptoj sanksion më të rëndë penal.

Komfor nenit 269 par.3 të KPRK-së, konfiskohet në mënyrë të përhershme substanca narkotike të llojit heroin me peshë 1.23 gram.

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 20 /njëzetë/ Euro, si dhe komfor nenit 39 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 05/L-036, për kompensimin e viktimave të krimit, të paguaj shumën prej 30 /tridhjetë/ Euro, brenda afatit prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore nga Ferizaj, me Aktakuzën e saj PP.II.nr.1271/20 e datës 30.11.2020 ka ngarkuar të pandehurin S.S nga Fshati ... Komuna Shtërpcë, për shkak të veprës penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 të KPRK-së.

Gjykata Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm, duke vepruar në këtë çështje penale sipas nenit 245 të KPPRK-së, caktoi dhe mbajti shqyrtimin fillestar me datë 05.04.2022,

dhe pas leximit të aktit akuzues, gjyqtari u bind se i pandehuri e ka kuptuar akuzën, komfor nenit 246 par. 4 të pandehurit i ofroj mundësinë të pranojë fajësinë ose të deklarohet i pafajshëm.

I akuzuarit S.S, në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale e cila iu vihet në barrë sipas të gjitha pikave të saj, është i vetëdijshëm për pranimin dhe pasojat që mund të vijnë nga ky pranim, ndihet thellë i penduar për këtë vepër penale, shpreh keqardhje për këtë, premton se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla, dhe ka kërkuar nga gjykata që ti shqiptoj një dënim sa më të butë.

Prokurori i shtetit, me rastin e paraqitjes së mendimit të tij, ka propozuar që të pranohet pranimi i fajësisë për të akuzuarit, pasi pranimi fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe në përputhje me dispozitat ligjore të nenit 248 par 1 të KPPRK si dhe provat materiale të shkresave të lëndës.

Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë shqyrtoi me kujdes kushtet e parapara nga neni 248 par.1 të KPPRK-së dhe me këtë rast vlerësoi se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit si: Raporti i oficerit i datës 07.07.2020, raporti i ekspertimit nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë e datës 17.11.2020, vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të gjëseneve të datës 06.07.2020, foto – dokumentacioni si dhe shkresat e tjera që gjenden në lëndë.

Me qenë se i akuzuari ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj gjyqtari komfor nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Gjykata vërtetoi përtej çdo dyshimi se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 të KPRK-së, meqë me datë, vend dhe kohë siç është përshkruar hollësisht në diapozitivin e këtij aktgjykimi, andaj duke marrë parasysh se në veprimet inkriminuese të tij janë përmbushur elementet e veprës e cila i vihet në barrë, i njëjti është gjetur penalisht përgjegjës dhe është shpallur fajtorë për këtë vepër penale.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, Gjykata vlerësoi rrethanat në kuptim të nenit 69, 70 dhe 71 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese

përkatësisht që në shqyrtimi gjyqësor i pandehuri ka pranuar fajësinë, rrethana lehtësuese pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer, gjendja e dobët ekonomike, kurse në rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë veçanërisht rënduese përveç që vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, ndërsa me rastin e vlerësimi të rrethanave rënduese gjykata nuk gjeti në rastin konkretë.

Mbi bazën e këtyre rrethanave, gjykata është e bindur se dënimi i shqiptuar është në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të pandehurit, duke marrë parasysh edhe faktin se i njëjti ka bërë pranimin e fajësisë, duke vlerësuar se edhe me sanksion të posaqshëm penal si vërejtja gjyqësore, me anë të së cilit kryesit i jepet qortim dhe i bëhet me dije se ka kryer vepër të dëmshme dhe të rrezikshme, andaj shqiptimi i saj është i mjaftueshëm për të arritur qëllimin e dënimit i paraparë në nenin 38 të KPRK-ës përkatësisht vërejtja e shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Vendimi mbi konfiskimin e substancës narkotike është marr në kuptim të dispozitës së nenit 269 par.3 të KPPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet procedurës gjyqësore është marr në kuptim të dispozitës së nenit 453 par. 1 të KPPRK-së, ndërsa për kompensimin e viktimave të krimit është marrë komfor nenit 39 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 05/L-036, për kompensimin e viktimave të krimit.

Nga arsyet e lartë shënuara u vendos si në diapozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

2020:128705, 08.08.2022

G j y q t a r i

Shabi Idrizi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.